



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.3.2023

Nr: 169

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË QENDRËS MEDIATIKE MCA – PRESS & GIR, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 11.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** Qendrës Mediatike MCA – PRESS & GIR, me seli në Tiranë, Kutia Postare 8314

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

V Ë R E J:

Qendra Mediatike MCA-PRESS & GIR i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

Data: 11.3.2023 Nr: 169  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së Qendrës Mediatike MCA – PRESS & GIR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Qendra Mediatike MCA-PRESS & GIR është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

#### **V E N D O S:**

1. Akreditimin si përfaqësues të medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të 3 (tre) gazetarëve të Qendrës Mediatike MCA-PRESS & GIR, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**